



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura III

Nr. 5

Prishtinë, më 20 mars 2008, ora 10:00

**Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës,
salla N-225**

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Hajdin Abazi, Armend Zemaj, Myrvete Pantina, Besa Gaxherri, Kosara Nikolić, Müfera Şinik, Shkumbin Demaliaj.

Anëtarët që munguan: Behxhet Pacolli, Xhevdet Neziraj.

Të pranishëm ishin edhe : monitorues nga USAID, OSCE, KDI.

Nga Sekretaria e Kuvendit: Natasa Prica-Tisma, Zyrtare e lartë ligjore, Arta Hajra, zyrtare ligjore, Vilson Ukaj, Zyrtar ligjor.

Kryesues: Gani Koci, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës i propozuar:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/9 për Kooperativat e bujqve, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente;**

4. **Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2003/25 të datës 6 korrik 2003, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjqësi;**
5. **Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parasë;**
6. **Shqyrtimi i draft-propozimit të Planit të Punës së Komisionit për vitin 2008;**
7. **Të ndryshme.**

Kryetari hapi mbledhjen duke ftuar anëtarët për miratim të propozimit të rendit të ditës. Rendi i ditës u miratua pa vërjetje.

Kryetari hapi për shqyrtim pikën e dytë të rendit të ditës

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua me vërejtjet e znj. Safete Hadergjonaj dhe z. Shkumbin Demaliaj.

Kryetari vazhdoi me hapjen për shqyrtim të pikës së tretë të rendit të ditës

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/9 për Kooperativat e bujqve, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente

Kryetari paraqiti qëndrimin e vet lidhur me projektligjin në shqyrtim dhe raportin me amendamente të komisionit funksional duke u thënë se si projektligji ashtu edhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore, por veç se e plotësojnë dhe përmirësojnë ligjin ekzistues në fuqi. Sipas tij amendamentet e komisionit funksional, sidomos në nenin 21 duhet të përkrahen pasi që bëjnë një sqarim dhe shkallëzim më të mirë të masave ndëshkimore në dispozitat sanksionuese të projektligjit dhe kjo do të jetë edhe më praktike dhe e arsyeshme në zbatim të ligjit.

Kosara Nikolic shprehu pajtimin e saj me kryetarin lidhur me përkrahjen e amendamenteve të propozuara nga komisioni funksional, duke theksuar se si anëtare gjithashtu edhe e Komisionit për bujqësi, pylltari, zhvillim rural e planifikim hapësinor që për këtë projektligj është komision funksional, është e njohur mirë me punën e bërë në atë komision dhe projektligji është shqyrtuar me mjaft vëmendje dhe kujdes. Një punë e tillë gjithsesi se duhet të merret parasysh dhe të përkrahet.

Myrvete Pantina gjithashtu edhe anëtare e komisionit funksional për projektligjin në shqyrtim, u deklarua e pajtimit lidhur me miratimin e amendamenteve të komisionit funksional. Për të është më rëndësi që projektligji të përmbajë shkallëzim më të mirë të masave ndëshkimore për arsye të mos ngarkimit pa nevojë të personave me dënime më të larta. Sipas saj gjrobat e propozuara nuk janë të larta për fermerët, bujqit dhe personat që merren me kooperativa, pasi që ato shqiptohen vetëm në rastet e shkeljes së ligjit, dhe këta persona duhet të mësohen me rregullim ligjor të veprimtarisë së tyre.

Shkumbin Demaliaj u shpreh kundër lartësisë së gjobave të propozuara në projektligj dhe në amendamentet e komisionit funksional dhe për të këto gjoba janë të lartësisë së gjobave për vepra penale e jo për kundërvajtje. Në këtë drejtim ai ishte i mendimit që së pari duhet të shikohen ligjet tjera që sanksionojnë kundërvajtjet dhe veprat penale, të shikohet lartësia më e madhe për veprën kundërvajtje, e pastaj të propozohet në projektligj. Gjithashtu z. Demaliaj u shpreh kundër

shkallëzimit të gjobave për një kundërvajtje ku për një vepër caktohet kufiri më i ultë dhe ai më i lartë për një gjobë. Sipas tij lënia e mundësisë që personi i autorizuar për shqiptimin e gjobave të vlerësojë vet se cilën shumë të gjobës do ta shqiptoj brenda kufijve minimal dhe maksimal, mund të ndikojë edhe në korrupsionin e këtyre personave. Për këtë arsye ai propozoi që gjobat për veprat kundërvajtje të përcaktuara në projektligj të jenë precize.

Ky propozim hasi në kundërshtim të disa prej anëtarëve tjerë të komisionit dhe **kryetari** arsyetoi kundërshtimin duke thënë se çështja e shkallëzimit të gjobave është praktikë edhe në ligje tjera dhe kjo pasi që për një vepër të dënueshme ka forma dhe shkallë të ndryshme të kryerjes. Gjykata është ajo që vlerëson se në çfarë shkalle dhe forme është kryer vepra e dënueshme dhe varësisht nga kjo, e duke pasur parasysh edhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese, cakton shumën e gjobës nga kufijtë e ultë dhe të lartë të sanksionuar në ligj.

Armend Zemaj tha se për të këto gjopa të propozuara si në projektligj ashtu dhe në amendamente janë të larta dhe ai propozoi që në nenin 6 të Projektligjit që amendamenton nenin 21 të ligjit 2003/9, shumat për gjobat të jenë: në paragrafin 21.2 prej 300 euro deri në 1000 euro dhe në paragrafin 21.2 prej 2000 euro deri në 3000 euro.

Ky propozim nuk hasi në pajtim nga anëtarët e tjerë të komisionit.

Muferra Sinik u pajtua që të përkrahet projektligji me amendamente dhe për të lartësia e shumës së gjobave është e arsyeshme, pasi që në hartimin e këtij ligji janë angazhuar ekspertë që njohin këtë fushë veprimtari dhe janë kompetentë. Për të është e rëndësishme që të mos shkelet ligji, sepse çdo ligj që parasheh privilegje dhe përkrahje për një veprimtari, gjithsesi duhet të përmbajë edhe sanksionet në raste të shkeljes së tij.

Kryetari përkujtoi anëtarët e komisionit që nuk do ishte mirë që Komisioni për Buxhet dhe Financa të dalë më propozime të kundërta me ato të komisionit funksional, pasi që komisioni funksional është më i thirrur për të bërë vlerësimin e veprimtarisë së kooperativave të bujqve.

Haki Shatri u shpreh i pajtimit lidhur me përkrahjen e projektligjit me amendamentet e komisionit funksional, pasi që amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore e gjithashtu edhe në projektligj, në deklaratën financiare të tij theksohet se kostoja e projektligjit është e përbalueshme. Gjithashtu z. Shatri propozoi edhe një amendament në projektligj, për të cilin ftoi anëtarët që ta përkrahin.

Propozimi i amendamentit të z. Shatri është si në vijim:

Në nenin 6 të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/9 për kooperativat e bujqve të shtohet paragrafi i ri 21.4 si në vijim:

“ Mjetet e realizuara nga pagesa e dënimeve për shkelje të dispozitave të këtij ligji derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.”

Arsyetimi

Pasi që as në Ligjin nr.2003/9 në fuqi dhe projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji, nuk ekziston një dispozitë e tillë, është e nevojshme që këto ligje të plotësohen edhe me një dispozitë të re e cila do të sqaronte dhe precizonte vendin e grumbullimit të mjeteve nga gjobat e shqiptuara. Kjo dispozitë është në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, dhe gjithashtu ndodhet në të gjitha ligjet tjera që përmbajnë dispozita të tilla që sanksionojnë gjopa.

Pas diskutimeve dhe komenteve nga ana e anëtarëve të komisionit, kryetari vuri në votim projektligjin me amendamentet e komisionit funksional dhe propozimin për amendament të z. Shatri, dhe Komisioni me shumicë votash nxori këtë

Rekomandim

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa përkrahë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/9 për Kooperativat e bujqve dhe konstaton se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa përkrahë raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisionit për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe konstaton se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe të njëjtat në tërësi i përkrahë.
- III. Komisioni i rekomandon Kuvendit propozimin për ndryshimin në vijim:

Amendamenti 1

Në nenin 6 të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/9 për kooperativat e bujqve të shtohet paragraf i ri 21.4 si në vijim:

“ Mjetet e realizuara nga pagesa e dënimeve për shkelje të dispozitave të këtij ligji derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.”

Në vazhdim kryetari hapi shqyrtim pikën e katërt të rendit të ditës

4. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2003/25 të datës 6 korrik 2003, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Kryetari bëri të ditur për anëtarët se projektligji dhe rekomandimet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore. Projektligji vetëm parasheh një institucion të ri në Kodin penal, atë të pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit, kurse komisioni funksional në rekomandimet e tij nuk ka propozuar amendamente por vetëm miratimin dhe përkrahjen e projektligjit.

Me këtë rast ai ftoi anëtarët e komisionit për miratim të projektligjit me rekomandimet e komisionit funksional.

Pasi që nuk pati anëtarë të tjerë të komisionit të lajmëruar për diskutim, kryetari vuri në votim projektligjin me rekomandimet e komisionit funksional.

Komisioni me 11 vota për dhe asnjë kundër nxori këtë

Rekomandim

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa përkrahë Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe konstaton se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.

- II.** Komisioni për Buxhet dhe Financa përkrahë raportin me rekomandime të komisionit funksional – Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe konstaton se rekomandimet nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe të njëjtat në tërësi i përkrahë.

Kryetari hapi shqyrtim pikën e pestë të rendit të ditës

5. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parasë

Kryetari në vazhdim njoftoi anëtarët e Komisionit për letrën dërguar kryetarit të Kuvendit duke kërkuar informim dhe sqarim lidhur me kompetencat që institucionet vendore do ti kenë tani pas pavarësisë e gjithashtu që janë të përcaktuara përmes Pakos së Ahtisarit. Kjo në mënyrë që komisioni të dijë se si ti rregullojë (shpërndajë) këto kompetenca ndërmjet institucioneve që janë objekt i rregullimit të Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parasë.

Gjithashtu kryetari njoftoi anëtarët e komisionit për takimin që ka pasur me përfaqësues të Ambasadës amerikane në Kosovë dhe ndihmës së ofruar nga kjo ambasadë që të ndihmojë me rekomandime Komisionin lidhur me projektligjin në shqyrtim. Me këtë rast kryetari theksoi se i ka premtuar këtyre përfaqësuesve në takim, se komisioni do tu lë një hapësirë kohore për përgatitjen dhe përcjelljen e këtyre rekomandimeve e pastaj Komisioni do ti shqyrtojë dhe bëjë amendamentet e nevojshme.

Ky qëndrim hasi në mirëkuptim nga anëtarët e tjerë të komisionit dhe ata u pajtuan që të presin për rekomandimet që do tu ofrohen nga Ambasada amerikane në Kosovë e gjithashtu edhe nga grupet tjera të interesuara për të dhënë kontributin e tyre në amendamentimin e Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parasë.

Anëtarët Armend Zemaj, Besa Gaxherri, Haki Shatri dhe Shkumbin Demaliaj kërkuan të dinë nga kryetari nëse ka ndonjë informatë lidhur me çështjen e kompensimit të profesorit Haki Demolli për përgatitjen e rekomandimeve dhe propozim amendamenteve në projektligjin në shqyrtim për komisionin e mandatit të kaluar, si qëndron situata dhe si mund të realizohet ky kompensim?.

Kryetari informoi anëtarët për përcjelljen e sërishme për Kryesinë e Kuvendit të kërkesës nga komisioni i mandatit të kaluar për kompensimin e profesorit Haki Demolli për punën e bërë dhe gjithashtu për pengesat në procedurë të cilat janë paraqitur nga Administrata e Kuvendit. Këto pengesa kanë të bëjnë me atë se nuk ekziston ndonjë kontratë e lidhur mes profesorit dhe komisionit të kaluar, pasi që komisioni e ka ftuar profesorin për bërë punën e tij për komisionin e nuk e ka zgjedhur ndër oferta tjera, në këtë rast nuk ka shkuar në procedurë të tillë të ofertimit. Në anën tjetër ekziston një vendim i Kryesisë së Kuvendit që të gjithë ekspertët e ftuar në mbledhje të komisionit, kur kërkohet nga komisioni një mendim ose ekspertizë ligjore do të paguhet me një mëditje prej 35 euro për pjesëmarrje në mbledhje. Mirëpo një rregull e tillë nuk mund të zbatohet në rastin e profesorit në fjalë, pasi që ai ka kryer punë për komisionin jashtë mbledhjeve dhe për një periudhë disa mujore dhe nuk mund të bëhet një llogaritje e tillë.

Pas kësaj informate nga ana e kryetarit, të gjithë anëtarët u pajtuan që duhet të insistojnë në kompensimin e profesorit Haki Demolli për punën e tij dhe duhet të vazhdojnë të kërkojnë nga Kryesia dhe Administrata e Kuvendit për të gjetur formën e përshtatshme për realizimin e kompensimit të tillë.

Me pas, kryetari hapi për shqyrtim pikën e gjashtë të rendit të ditës

6. Shqyrtimi i draft-propozimit të Planit të Punës së Komisionit për vitin 2008

Kryetari përkujtoi anëtarët e komisionit, se marrëveshja nga mbledhja e kaluar që deputetët e komisionit të përcillnin me shkrim rekomandimet e tyre për planin e punës së komisionit për vitin 2008 nuk është përmbushur, pasi që asnjëri nga anëtarët nuk ka bërë një gjë të tillë. Kjo zgjatë kohën e përgatitjes dhe miratimit të planit të punës.

Pasi që anëtarët kishin para vetes një propozim plan të punës të përgatitur nga zyra mbështetëse e komisionit në bashkëpunim me asistentin e NDI të angazhuar për komisionin, kryetari ftoi anëtarët që të paraqesin propozimet dhe rekomandimet në këtë propozim plan.

Pas diskutimeve të bëra nga anëtarët e komisionit, propozimet të cilat u përkrahën nga të gjithë anëtarët e komisionit që të përfshihen në propozim planin e punës, janë si në vijim:

- Planit të punës të propozuar, në pjesën tabelare të tij, duhet ti shtohet edhe një kolonë më shumë në secilin muaj të vitit që të paraqesë veprimtarinë e komisionit që ka në shqyrtimin e të gjitha projektligjeve që i propozohen Kuvendit.
- Në planin e punës të propozuar, në pjesën tabelare ku në muajin dhjetor parashihet organizimi dhe realizimi i dëgjimeve buxhetore për organizatat buxhetore lidhur me kërkesat tyre buxhetore, të bëhet ndërrimi i kësaj veprimtarie në muajin nëntor ose më herët.
- Në planin e punës të parashihet, përveç vizitave zyrtare nëpër komuna të Kosovës, gjithashtu edhe vizitë në ndonjë nga vendet e rajonit ose Bashkimit Evropian, për tu mësuar me përvojat e shteteve tjera e sidomos komisioneve homologe në efekt të përmirësimit të punës së Komisionit.

Me pas, kryetari kaloi në shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës

7. Të ndryshme

Besa Gaxherri propozoi dhe kërkoi prej anëtarëve të komisionit përkrahje që mbledhjet e Komisionit të mos caktohen më herët se ora 11:00, për shkak se deputetët të cilët udhëtojnë nga qytetet tjera të Kosovës, e kanë të vështirë të mbërrijnë me kohë në mbledhje të parapara në orët e mëngjesit. Nëse do të përkrahet një propozim i tillë, sipas znj. Gaxherri do të jetë në efekt të një punë më të mirë dhe bashkëpunimi më të thellë në mes anëtarëve, sidomos kur do të merreshin vendime në një mbledhje ku do të kenë mundësi të jenë të pranishëm të gjithë anëtarët e komisionit.

Një propozim i tillë u përkrah edhe nga anëtarët e tjerë të komisionit dhe Kryetari konstatoi se Komisioni u pajtua që mbledhjet e ardhshme të caktohen prej orës 11:00, kurse në rastet specifike kur kërkohet një orar tjerë për mbledhje, të mos caktohet mbledhja më herët se ora 11:00.

Mbledhja përfundoi në ora 11:30
Shërbimi i komisioneve

Kryetari i Komisionit

Gani Koci